

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), Komisioni Vendimmarrës për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, i përbërë nga: Dimitrija Vrevezoski - kryetar, Prof. dr. Vladimir Naumovski dhe Naser Zharku - anëtarë, duke vepruar në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare me Konkluzion për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-8/1 të datës 01.02.2017, kundër Shoqërisë për Shërbime Intelektuale JAVOR-KOP SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm: **Shoqëria për Shërbime Intelektuale Brainobrain Europe SHPKNJP**) me seli në Naroden Front nr.17-lamella 1/lokal 2 Shkup, me qëllim të konstatimit të shkeljes së nenit 59 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, në seancën e mbajtur më 20.04. 2022, solli:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se Shoqëria për Shërbime Intelektuale JAVOR-KOP SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm: **Shoqëria për Shërbime Intelektuale Brainobrain Europe SHPKNJP**) me seli në Naroden Front nr.17- lamella 1/lokal 2 Shkup, me NVT 4032011514816, në periudhën **nga data 30.10.2011, si dita e lidhjes së marrëveshjes së parë të Franshizës, e cila përmbante klauzolë kufizuese deri më 01.09.2018, si dita e përfundimit të marrëveshjes së franshizës të lidhur ndërmjet Javor KOP (me emrin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, Filial I SVETILNIK EDUKARE, si dita e përfundimit të kontratës së fundit e cila përmbante një dispozitë kufizuese** në 29 raste kushtëzoi lidhjen e marrëveshjeve të franshizës me shfrytëzuesit e franshizës duke pranuar një detyrim nga ana e franshizës, detyrime shtesë, të cilat për nga natyra e tyre ose në përputhje me zakonet tregtare nuk kanë lidhje me objektin e kontratës, në atë mënyrë që në:

1. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënës i franshizës dhe **Organizatës Komunale të Kryqit të Kuq Ohër, Maqedoni**, si shfrytëzuese e franshizës;
2. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Abakus Plus - Manastir**, si shfrytëzuese e franshizës;
3. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Qendra Edukative Svetilnik, Shkup - Lokacioni i Sallës Universale**, si shfrytëzuese e franshizës;
4. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.03.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Xhonova XHaxhova Emilija, me adresë në rr. Trajko Kosheski nr. 23 Shtip**, si shfrytëzuese e franshizës;

5. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.03.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **E-Konsalting, Koçan**, si shfrytëzuese e franshizës;

në pikën 6.3 a) parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" nga të njëjtat kontrata, përcaktohet një tarifë mujore fikse që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do t'i mbledhë nga studentët e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrein dhe dispozitat" parashikohet një tarifë fikse mujore për nivel, e cila do të tarifohet dhe do të mblidhet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student dhe se një ndryshim në shumën e tarifës kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

6. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Brainobrain Juniors rr. Meksiçka 14b, Shkup**, si shfrytëzuese e franshizës;
7. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Frutberry SHPKNJP Strumicë - filiali Vonderkit rr. Kliment Ohridski pn/rruga proseniçki, Strumicë**, si shfrytëzuese e franshizës;

në pikën 6.3 a) parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 22 të pjesës të titulluar "Orari" nga e njëjta kontratë, që Master Franshizori përcakton 3 kategori tarifash fikse për tarifimin mujor të kursit Breinobrein për çdo student në varësi të numrit të banoreve në qytet dhe në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrein dhe dispozitat" parashikohet një tarifë fikse mujore për nivel, e cila do të tarifohet dhe do të mblidhet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student dhe se një ndryshim në shumën e tarifës kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

8. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe shoqata private e qytetarëve për zhvillimin e aftësive dhe vlerave njerëzore **Qendra Edukative Svetilnik, rr. Metodija Mitevski nr.5/4-7 Shkup**, si përfitues i franshizës;
9. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.12.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NETING SHPKNJP import-eksport, rr. Ilindenska 18a Tetovë**, si përfitues i franshizës;

10. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.02.2013, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata e qytetarëve për zhvillimin e aftësive dhe vlerave njerëzore Qendra Edukative Svetilnik Shkup, rr. Metodija Mitevski nr.5/4 7 Shkup**, si përfitues i franshizës;
11. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 24.09.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqëria për prodhim dhe tregti ELMO-TEHNA Lubenço SHPKNJP import-eksport, rr. Blagoj Gjorev nr.36/1-13 Veles**, si përfitues i franshizës;
12. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.04.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës **MALI GENIJALCI SHPKNJP rr. Gjen. Vasko Karangelovski nr. 1 GTC keops BITOLA**, si përfitues i franshizës;
13. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2013, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata për zhvillim mendor Brain Ginis - Kumanovë, rr. MUB nr. 124 Kumanovë**, si përfitues i franshizës;

në Nenin 20 parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrein dhe dispozitat" parashikohet një tarifë fikse mujore për nivel, e cila do të tarifohet dhe do të mbliidhet nga shfrytëzuesi i franshizësi (franshizori) nga çdo student dhe se një ndryshim në shumën e tarifës kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

14. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **DTU JUNIORS Klub SHPKNJP Shkup**, si përfitues i franshizës;
15. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **SHKOLLA EDUKATIVE SIGMA SHPKNJP rr. Ilindenska pn, Kriva Pallankë**, si përfitues i franshizës;
16. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqëria për edukim dhe shërbime OKSIGJENI 2013 SHPKNJP Shkup**, si përfituese e franshizës;
17. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata për zhvillim mendor Brain Ginis - Kumanovë, rr. MUB nr. 124 Kumanovë**, si përfitues i franshizës;
18. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **TERMAL KOMFORT SHPKNJP Gostivar-**

filiali 2 QENDRA PËR EDUKIM MODERN-TCE, rr. Beliçica nr. 51 Gostivar, si përfitues i franshizës;

19. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 28.04.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve BRAINOBRAIN KIDS, rr. Gemixhiska nr.57 Shkup**, si përfitues i franshizës;
20. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **BRAINOBRAIN NOVA SHPKNJP, rruga Lazar Liçenoski nr.27, Shkup**, si përfitues i franshizës;
21. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, Filiali I SVETILNIK EDUKARE rr. Borka Talevski nr.49/3 Shkup**, si përfitues i franshizës;
22. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 03.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **E-Konsalting, Koçan**, si përfitues i franshizës;
23. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 14.09.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve rr. ABAKUS. Kosta Novakovuq nr.7/1-3 Shkup**, si përfitues i franshizës;
24. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 21.09.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **LINGVA 2006 SHPKNJP rr. Marshall Tito nr. 65 BITOLA**, si përfitues i franshizës;
25. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.02.2016, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **DUPT ARITMETIKA M SHPKNJP import-eksport, rr. Cvetan Dimov nr. 72 Strumicë**, si përfitues i franshizës;
26. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 21.03.2016, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër, rr. Dimitar Vlahov nr. 52, Ohër**, si përfitues i franshizës. Kontrata lidhet për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare;

në nenin 8 parashikohet që përfituesi i franshizës (franshizori) detyrohet nga vizitorët e kursit të Brainobrain të paguaj një tarifë mujore fikse dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashikohet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak të Shfrytëzuesit të Franshizës, të ndryshojë tarifën për shkallën që e paguajnë dëgjuesit.

27. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve rr. ABAKUS. Kosta Novakoviç nr.7/1-3 Shkup**, si përfitues i franshizës;
28. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 18.11.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër, rr. Dimitar Vlahov nr. 52, Ohër**, si përfitues i franshizës;
29. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 22.01.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **DA VINÇI GAB SHPKNJP, rr. Goce Dellçev nr. 64, Kumanovë**, si përfitues i franshizës.

në nenin 6 a) parashikohet se Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup (dhënësi i Franshizës) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë shumën e tarifës mujore që e paguajnë vizitorët e kursit dhe në nenin 8 të së njëjtës marrëveshje parashikohet që Qendra e Franshizës, gjatë regjistrimit të vizitorëve në kurs, Brainobrain është i detyruar t'u dorëzojë prindërve të vizitorëve të kursit një fletëpagesë në bazë të së cilës ata do të paguajnë një tarifë mujore fikse për ndjekësit e kursit

që paraqet shkelje të shumta të nenit 59 paragrafi (1) pika 1), dhe në lidhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 5) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe nenit 28 paragrafi (1) të ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 124/15).

2. Për kundërvajtjen e kryer nga pika 1 e këtij aktvendimi, kryesit, Shoqërisë për shërbime intelektuale JAVOR-KOP SHPKNJP Shkup (me emrin e mëparshëm: Shoqëria për shërbime intelektuale Brainobrain Europe SHPKNJP), nuk i shqiptohet gjobë, sepse vlera e të hyrave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin 2021 si viti paraprak financiar, është 0 denarë.

Arsyetim

KVK, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me Aktvendimin PP nr. 09-30/2, të miratuar në seancën e mbajtur më 10.10.2016, ngarkoi **Shoqërinë për Shërbime Intelektuale JAVOR-KOP SHPKNJP Shkup** (me emrin e mëparshëm: Shoqëria për shërbime intelektuale Brainobrain Europe SHPKNJP), (në tekstin e mëtejme: **Javor KOP** (me emërtimin e mëparshëm: **BOB Europe SHPKNJP, Shkup**)) të dorëzojë në KVK të gjitha marrëveshjet e franshizës me subjektet në territorin e Republikës së Maqedonisë që Javor KOP (me emrin e mëparshëm: **BOB Europe SHPKNJP, Shkup**) i ka lidhur/kanë qenë në fuqi nga viti 2010 deri në ditën e prononcimit sipas Konkluzionit të theksuar PP nr.09-30/2.

Me datë 14.10.2016, Avokatja Hristina Stojanoviç, e autorizuar e Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), me shkresën PK nr.09-30/3, dorëzoi në KVK, Kërkesë për kontroll dhe fotokopje.

Me shkresën PK nr. 09-30/4 të datës 21.10.2016, Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), dorëzoi përgjigje për Konkluzionin PK nr. 09-30/2 në KVK, duke dorëzuar si bashkëngjitje marrëveshjet e franshizës që i ka lidh me Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) nga viti 2010 deri në ditën e dorëzimit të shkresës në fjalë.

Me datën 31.10.2016, KVK me shkresën PK nr. 09-30/5 dorëzoi përgjigje në kërkesën për kontroll dhe fotokopje në Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Në seancën e mbajtur më 1.02.2017, KVK ka miratuar Konkluzion për inicim të procedurës për kundërvajtje PK nr. 09-8/1. Me shkresën PK nr. 09-8/1 të datës 03.02.2017, KVK ka dorëzuar Konkluzion për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Me shkresën PK nr.09-8/2 të datës 15.02.2017, Javor KOP (me emrin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), ka dorëzuar përgjigje në Konkluzionin për fillimin e procedurës për kundërvajtje PK nr. 09-8/1 në KVK.

Në seancën e mbajtur më 23.03.2017, KVK , miratoi Njoftimin paraprak për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-8/3. Me shkresën PK nr. 09-8/3 të datës 23.03.2017, KVK, ka dorëzuar Njoftim paraprak për gjendjen e vërtetuar faktike në Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Me shkresën PK nr.09-8/4 të datës 10.04.2017, Javor KOP (me emrin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), u prononcua pas njoftimit paraprak për e gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-8/3.

Në seancën e mbajtur më 24.04 2017, KVK miratoi Konkluzion për kërkesën e të dhënave PK nr. 09-8/5. Me shkresën PK nr. 09-8/6 nga data 05.05.2017, KVK ka dorëzuar Konkluzionin për kërkesën e të dhënave PK nr. 09-8/5 te Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) dhe kërkoi që të dorëzohen të hyrat totale të realizuara në bazë të Marrëveshjeve të Franshizës me përfituesit e franshizës në vitin 2016.

Me shkresën 09-8/7 të datës 05.11.2017, Javor KOP (me emrin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup përgjigjet në Konkluzionit për kërkesën e të dhënave PK nr. 09-8/5 në KVK.

Në seancën e mbajtur më 15.05 2017, KVK miratoi Njoftimin përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-8/8. Me shkresën PK nr. 09-8/8, të datës 15.05.2017, KOP ka dorëzuar Njoftimin përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-8/8 për Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Me shkresën PK nr. 09-8/9 të datës 31.05.2017, Javor KOP (me emrin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) u prononcua pas njoftimit përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-8/8 në KVK.

Bashkangjitur shkresës PK nr. 09-8/10 nga 14.06.2017, Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) i dorëzoi KVK-së kontratat e korrigjuara dhe anekset e marrëveshjeve të franshizës.

Me shkresën PK nr. 09-8/11 nga data 15.08.2017, Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) ka dorëzuar në KVK, plotësim të njoftimit për marrëveshjet të korrigjuara.

KVK në seancën e mbajtur më 29.11.2017 ka miratuar Aktvendimin PA Nr. 09-8/12.

Me Aktvendimin e lartpërmendur PK nr. 09-8/12, KVK, konstatoi se Shoqëria për shërbime intelektuale Brainobrain Europe SHPKNJP, Shkup me seli në bul Jane Sandanski nr. 21/1-7, Shkup, me NVAS 6732534, NUT 4032011514816, xhirollogaria nr. 240040002277878 në Uni Bank SHA Shkup dhe personi i autorizuar Klaudia Ehmer-Vorgiq, menaxhere, e përfaqësuar nga e autorizuar Hristina Stojanoviq, avokate nga Shkupi, në periudhën nga data 30.10.2011 deri në datën e miratimit të këtij aktvendimi, në 29 raste ka kushtëzuar lidhjen e marrëveshjeve të franshizës me shfrytëzuesit e franshizës me pranimin e detyrimit nga ana e shfrytëzuesit të franshizës, detyrime shtesë, të cilat për nga natyra e tyre ose në përputhje me zakonet tregtare nuk kanë lidhje me objektin e kontratës, në atë mënyrë që në:

1. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe **Organizatës Komunale të Kryqit të Kuq Ohër, Maqedoni**, si përfituese e Franshizës;
2. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe **Abakus Plus – Manastir**, si përfituese e franshizës;
3. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe Qendra Edukative Svetilnik, Shkup - Lokacioni i Sallës Universale, si përfituese e franshizës;
4. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.03.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe Xhonova Xhaxhova Emilija, me adresë në rr. Trajko Kosheski nr. 23 Shtip, si përfituese e franshizës;
5. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.03.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe E-Konsalting, Koçan, si përfituese e franshizës;

në pikën 6.3 a) parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizori/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguhet nga pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës së titulluar "Orari" nga të njëjtat kontrata, fiksohet një tarifë mujore fikse të cilën shfrytëzuesi i franshizës (franshizuesi) do ta mbledhë nga studentët e tij në muaj dhe si shtesë në rregullën 4 të pjesës së titulluar " Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" parashikohet një tarifë mujore fikse për nivel që do të paguhet dhe mbledhet nga shfrytëzuesi i franshizës (Franshizori) nga secili student dhe për ndryshimin e shumës së kompensimit kërkohet miratim me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

6. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe **Brainobrain Juniors rr.Meksička 14b, Shkup**, si përfituese e franshizës;
7. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe **Frutberry SHPKNJP Strumicë-dega Vonderkit rr. Kliment Ohridski pn /rruga “prosenicki” Strumicë**, si përfituese e franshizës;

në pikën 6.3 a) parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizori/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguhet nga pjesëmarrësit, në pikën 22 të pjesës me titull “Orari” të së njëjtës marrëveshje, parashikohet që Master Franshizori të përcaktojë 3 kategori me një kompensim të caktuar fikse për pagesën e kursit mujor Brainobrain për çdo student në varësi të numrit të banorëve në qytet dhe në Rregullin 4 të pjesës së titulluar “ Rregullat dhe rregulloret Breinobrein” parashikohet që kompensimi sipas nivelit që do të paguhet dhe mblidhet nga shfrytëzuesi i franshizës (Franshizori) nga çdo student në muaj dhe për ndryshimin e shumës së kompensimit kërkohet miratim me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

8. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe Shoqata private e qytetarëve për zhvillimin e aftësive dhe vlerave njerëzore **Qendra Edukative Svetilnik, rr. Metodija Mitevski nr.5/4-7 Shkup**, si përfituese e franshizës;
9. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.12.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NETING SHPKNJP import-eksport, rr. Ilindenska 18a Tetovë**, si përfituese e franshizës;
10. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.02.2013, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënëse e franshizës dhe Shoqata private e qytetarëve për zhvillimin e aftësive dhe vlerave njerëzore **Qendra Edukative Svetilnik, rr. Metodija Mitevski nr.5/4-7 Shkup**, si përfituese e franshizës;
11. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 24.09.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe Shoqëria për prodhim dhe tregti **ELMO-TEHNA Lubenço SHPKNJP import-eksport, rr. Blagoj Gjorev nr.36/1-13 Veles**, si përfituese e franshizës;
12. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.04.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **MALI GENIJALCI SHPKNJP rr. Gen. Vasko Karangelovski nr. 1 GTC keops BITOLË**, si përfituese e franshizës;

13. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2013, **ndërmjet Breinobrein Internacional SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe Shoqata për zhvillim mendor **Brain -Ginis Kumanovë, rr. MUB nr. 124 Kumanovë**, si përfituese e franshizës;

në Nenin 20 a) parashikohet që Master Franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrein dhe dispozitat" parashikohet që kompensimi për nivel, që do të paguhet dhe mbliidhet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se për ndryshimin e shumës së kompensimit kërkohet miratim me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

14. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **DTU JUNIORS Klub SHPKNJP Shkup**, si përfituese e franshizës;

15. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **SHKOLLA EDUKATIVE SIGMA SHPKNJP, rr. Ilindenska pn, Kriva Pallankë**, si përfituese e franshizës;

16. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Shoqëria për edukim dhe shërbime OKSIGJENI 2013 SHPKNJP Shkup**, si përfituese e franshizës;

17. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe Shoqata për zhvillim mendor **BRAIN-GINIS, Kumanovë**, si përfituese e franshizës;

18. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **TERMAL KOMFORT SHPKNJP Gostivar-Filiali 2 QENDRA PËR EDUKIM MODERN-TCE, ul. Beliçicë nr. 51 Gostivar**, si përfituese e franshizës;

19. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 28.04.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve BRAINOBRRAIN KIDS, rr. Gemixhiska nr. 57 Shkup**, si përfituese e franshizës;

20. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **BRAINOBRRAIN NOVA SHPKNJP, rruga Lazar Liçenoski 27, Shkup**, si përfituese e franshizës;

21. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.09.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, Dega I SVETILNIK EDUKARE rr. Borka Talevski nr. 49/3 Shkup**, si përfituese e franshizës;

22. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 03.09.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **E-Konsalting, Koçani**, si përfituese e franshizës;
23. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 14.09.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS rr. Kosta Novakovuq nr.7/1-3 Shkup**, si përfituese e franshizës;
24. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 21.09.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **LINGVA 2006 SHPKNJP, rr. Marshall Tito Nr. 65 BITOLA**, si përfituese e franshizës;
25. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.02.2016, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **DUPT ARITMETIKA M SHPKNJP import-eksport, rr. Cvetan Dimov nr. 72 Strumicë**, si përfituese e franshizës;
26. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 21.03.2016, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër, rr. Dimitar Vlahov nr. 52, Ohër**, si përfituese e franshizës . Kontrata lidhet për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare;

në nenin 8 parashikohet që përfituesi i franshizës (franshizori) detyrohet nga vizitorët e kursit të Brainobrain të paguaj një tarifë mujore fikse dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashikohet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak të Shfrytëzuesit të Franshizës, të ndryshojë tarifën për shkallën që e paguajnë dëgjuesit.

27. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 01.10.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS rr. Kosta Novakovuq nr.7/1-3 Shkup**, si përfituese e franshizës;
28. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 18.11.2014, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër, rr. Dimitar Vlahov nr. 52, Ohër**, si përfituese e franshizës
29. Marrëveshja e franshizës e lidhur më 22.01.2015, **ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënëse e franshizës dhe **DA VINÇI GAB SHPKNJP, rruga Goce Dellçev nr. 64, Kumanovë**, si përfituese e franshizës.

në nenin 6 a) parashikohet se Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup (dhënësi i Franshizës) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë shumën e tarifës mujore që e paguajnë vizitorët e

kursit dhe në nenin 8 të së njëjtës marrëveshje parashikohet që Qendra e Franshizës, gjatë regjistrimit të vizitorëve në kurs, Brainobrain është i detyruar t'u dorëzojë prindërve të vizitorëve të kursit, një fletëpagesë në bazë të së cilës ata do të paguajnë një tarifë mujore fikse për ndjekjen e kursit.

që paraqet shkelje të shumta të nenit 59 paragrafi (1) pika 1), dhe në lidhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 5) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe **nenit 28 paragrafi (1) të ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 124/15),** për të cilën kryesit **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** i shqiptohet një sanksion - gjobë në shumë prej 1.263.607,00 denarë, që paraqet 10% nga vlera e të hyrave të përgjithshme vjetore të **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** të realizuar në vitin 2016 si viti i fundit afarist, për të cilën ndërmarrja ka përpiluar një llogari vjetore.

Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë me shkresë (UPRK. Nr. 8/2017, 22.12.2017) (Numri ynë PK Nr. 09-2/1, të datës 04.01.2018) dorëzoi Padi për inicim të kontestit administrativ.

Me datë 11.01.2018, KVK me shkresën PA nr. 09-2/2, dorëzoi Përgjigje në padi UPRK-së Nr. 8/2017 në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë.

Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut më datë 07.11.2019, solli aktgjykim UPRK. Nr. 8/2017 (Nr. ynë 09-33/1 i datës 25.12.2019) me të cilin padia e paditësit Javor Kop (me emërtim të mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP), Shkup, e parashtroi kundër aktvendimit të KVK-së, PK. Nr. 09-8/12, të datës 29.11.2017, e hodhi poshtë si të pabazuar.

Gjykata Administrative me 20.12.2019 me shkresë (Numri ynë PK nr. 09-19/1, të datës 11.03.2020) ka dorëzuar ankesën në KVK për përgjigje, që Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP), Shkup, përmes të autorizuarit Mefail Arslani, avokat nga Shkupi, ka deklaruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Administrative UPRK. nr. 8/2017 të datës 07.11.2019.

Më 18.03.2020, KVK me shkresë PK nr. 09-19/2 dorëzoi përgjigje në ankesë UPRK. Nr. 8/2017 në Gjykatën Administrative.

Me aktgjykim UPRZH Nr. 155/2020 të datës 06.09.2021, Gjykata e Lartë Administrative (në tekstin e mëtejshëm: GJLA) ka ndryshuar aktgjykimin e UPRK nr. 8/2017 të datës 07.11.2019 të Gjykatës Administrative dhe ka anuluar aktvendimin PP nr. 09-8/12. datë 29.11.2017 të KVK-së, duke e kthyer lëndën në rigjykim.

Pas dorëzimit të aktgjykimit nga Gjykata e Lartë Administrative, KVK, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, më 15.10.2021, nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka siguruar Historinë e ndryshimeve të Shoqërisë së shërbimeve intelektuale Brainobrain Europe SHPKNJP, Shkup, nga e cila është evidente se ndërmarrja ka ndryshuar emrin në Shoqëri për shërbime intelektuale JAVOR-KOP SHPKNJP Shkup.

Me datë 15.11.2021, Hristina Stojanoviq, avokate nga Shkupi, me e-mail dorëzoi parashtresën PK nr. 09-37/2 në KVK, me të cilën e njoftoi KVK-në se nuk është e autorizuar e Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Më datë 25.11.2021, KVK miratoi Konkluzion për kërkesën e të dhënave PK nr .09-37/3 nga kompania Javor KOP (e njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Me shkresë PK Nr. 09-37/4, KVK me datë 15.12.2021 ka tentuar të dorëzojë në adresën e ndërmarrjes. Më datë 22.12.2021, personi zyrtar bëri një përpjekje tjetër për një dorëzim të rregullt.

Më 15.02.2022, KVK bëri dorëzimin e Konkluzionit për kërkesën e të dhënave PK Nr. 09-37/3 në mënyrë elektronike në kutinë postare elektronike, në adresën elektronike të Javor KOP (emri i mëparshëm si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup).

Pas marrjes së të dhënave të nevojshme që janë me rëndësi për vendimmarrje të drejtë në procedurën e kundërvajtjes, KVK konstatoi gjendjen faktike si në vijim:

Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), është një ndërmarrje, dhënëse e franshizës për Kurse - kurs i avancuar për zhvillimin mendor të fëmijëve të moshës 4 deri në 14 vjeç, i cili realizohet sipas metodës së mbrojtur të mësimin me emrin "Brainiobrain", që lidhjen e marrëveshjeve të franshizës e kushtëzon duke pranuar një detyrim nga shfrytëzuesi i franshizës, kompensimin të cilët e paguajnë pjesëmarrësit e Kursit të përcaktohet nga Javor KOP (me emërtimin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) pa mundësi që shfrytëzuesi i franshizës të përcaktojë në mënyrë të pavarur çmimin e tij, i cili detyrim për nga natyra e tij ose sipas zakoneve tregtare nuk ka të bëjë me objektin e kontratës.

Shoqëria për shërbime intelektuale BREIN O BREIN Internacional SHPKNJP Shkup me seli në Bulevardin Jane Sandanski nr. 21/1-7 Shkup – Aerodrom është themeluar më 21.09.2011, dhe si themeluese dhe pronare e saj në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonia është shënuar Klaudija Ehmer-Vorgiq.

Më 17.06 2013, në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë është dorëzuar kërkesë për ndryshimin e emrit të Shoqërisë për shërbime intelektuale BREIN O BREIN Internacional SHPKNJP Shkup. Kërkesa është miratuar më 18.06. 2013. Emri i ri i Shoqërisë për shërbime intelektuale BREIN O BREIN Internacional SHPKNJP Shkup është Shoqëria e shërbimeve intelektuale BRAINOBRRAIN EUROPE SHPKNJP Shkup ose me emër të shkurtër BRAINOBRRAIN EUROPE SHPKNJP Shkup.

Më 19.05. 2020, në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut është dorëzuar një kërkesë për ndryshimin e emrit të Shoqërisë së shërbimeve intelektuale BRAINOBRRAIN EUROPE SHPKNJP Shkup. Kërkesa u miratua më 20.05.2020. Emri i ri i Shoqërisë për shërbime intelektuale BRAINOBRRAIN EUROPE SHPKNJP Shkup është Shoqëria e shërbimeve intelektuale MARENA-OBREND SHPKNJP.

Më 19.082021, në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut është dorëzuar një kërkesë për ndryshimin e emrit të Shoqërisë për shërbime intelektuale MARENA-OBREND SHPKNJP. Kërkesa u miratua më 19.08. 2021. Emri i ri i Shoqërisë për shërbime intelektuale MARENA-OBREND SHPKNJP është Shoqëria e shërbimeve intelektuale JAVOR – KOP SHPKNJP Shkup.

Në bazë të analizës së kontratave të dorëzuara, KVK konstatoi se Javor KOP (me emrin e mëparshëm si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), si dhënës i franshizës për Kurse- një kurs i avancuar për zhvillimin mendor të fëmijëve të moshës 4 deri në 14 vjeç, i cili kryhet sipas metodës së të mësuarit të mbrojtur me emrin "Brainiobrain", i cili, më e rëndësishmja, përfundon në sinergji me metodën e të mësuarit VAK. , gjimnastikë truri (Brain Gim), NLP dhe aritmetikë mendore ABAKUS dhe atë në 10/12 nivele, ku çdo nivel zgjat 3 deri në 4 muaj, dhe nivelet nuk mund të anashkalohen,, ai ka lidhur disa kontrata me shfrytëzuesit e franshizës, përkatësisht:

1. Marrëveshja për franshizë, e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **BreinBrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënës i franshizës dhe **Organizatës Komunale të Kryqit të Kuq Ohër, Maqedoni**, si përfituese e Franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 30.10.2016.

në pikën 6.3 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" - në pjesën përbërëse të marrëveshjes është paraparë që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do të arkëtojë 40 euro nga studentët e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" (f. 18 të Marrëveshjes) përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student është 40 euro në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

2. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 30.10 2011, ndërmjet **Breinebrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Abakus Plus - Manastir**, si shfrytëzues i franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 30.10.2016.

në pikën 6.3 a) nga marrëveshje e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" - në pjesën përbërëse të marrëveshjes është paraparë që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do të arkëtojë 45 euro nga studentët e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" (f. 18 të Marrëveshjes) përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student është 40 euro në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

3. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 30.10.2011, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Qendrës Edukative Svetilnik, Shkup, lokacioni Salla Universale**, si shfrytëzuese e franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 30.10.2016.

në pikën 6.3 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" nga e njëjta marrëveshje, është paraparë që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do të arkëtojë 40 euro nga studentët

e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student është 40 euro në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

4. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.03.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Xhonova Xhaxhova Emilija, me adresë në rr. Trajko Kosheski nr. 23 Shtip**, si përfitues i franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 01.03. 2017.

në pikën 6.3 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" nga e njëjta marrëveshje, është paraparë që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do të arkëtojë 40 euro nga studentët e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student është 40 euro në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

5. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.03.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe E-Konsalting - Koçan, si përfitues i franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 01.03. 2017.

në pikën 6.3 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" nga e njëjta marrëveshje, është paraparë që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do të arkëtojë 40 euro nga studentët e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student është 40 euro në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

6. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe Brainobrain Juniors, ul.Meksiçka 14 b, si përfitues i franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 01.09. 2015.

në pikën 6.3 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 22 të pjesës të titulluar "Orari" nga e njëjta marrëveshje, parashihet që Master Franshizori të caktojë 3 kategori për pagesën e kursit mujor Brainobrain për secilin student në varësi të numrit të banorëve në qytet, përkatësisht: 2460 mkd për banorët e qytetit të Shkupit, 1970 mkd për kategorinë e qytetit mbi 25000 banorë dhe 1540 mkd për kategorinë e qytetit nën 25000 banorë dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj

dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

7. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Frutberry SHPKNJP Strumicë/dega Vonderkit, rr. Kliment Ohridski pn/ rruga "prosenicki" Strumicë**, si përfitues i franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 01.09. 2015.

në pikën 6.3 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 22 të pjesës së titulluar "Orari" nga e njëjta marrëveshje, parashihet që Master Franshizori të caktojë 3 kategori për pagesën e kursit mujor Brainobrain për secilin student në varësi të numrit të banorëve në qytet, përkatësisht: 2460 mkd për banorët e qytetit të Shkupit, 1970 mkd për kategorinë e qytetit mbi 25000 banorë dhe 1540 mkd për kategorinë e qytetit nën 25000 banorë dhe gjithashtu në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

8. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.09.2012, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqata e qytetarëve për zhvillimin e aftësive dhe vlerave njerëzore Qendra Edukative Svetilnik, rr. Metodija Mitevski nr.5/4-7 Shkup**, si përfitues i franshizës. Kontrata është e vlefshme deri më 01.09.2015.

në pikën 20 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që Master franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit dhe në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

9. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.12.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime NETING SHPKNJP import-eksport, rr. Ilindenska 18a Tetovë**, si përfituese e franshizës. Kontrata është nënshkruar për 3 vjet.

në pikën 20 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që Master franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit dhe në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

10. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.02.2013, ndërmjet **Breinobrein Internacional SHPKNJP Maqedoni** si dhënës i franshizës dhe **Shoqata e qytetarëve**

për zhvillimin e aftësive dhe vlerave njerëzore Qendra Edukative Svetilnik Shkup, rr. Metodija Mitevski nr.5/4-7 Çair, Shkup, si përfitues i franshizës. Kontrata është nënshkruar për 3 vjet.

në pikën 20 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që Master franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit dhe në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

11. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 24.09.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup** si dhënës i franshizës dhe Shoqërisë për prodhim dhe tregti **ELMO-TEHNA Lubenço SHPKNJP import-eksport, rr. Blagoj Gjorev nr. 36/1-13 Veles**, si përfitues i franshizës. Kontrata është nënshkruar për 3 vjet.

në pikën 20 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që Master franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit dhe në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

12. Marrëveshja për bashkëpunim, e lidhur më 24.09.2013, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **MALI GENIJALCI SHPKNJP Manastir, rr. Gen. Vasko Karangeleski nr1 GTC KEOPS BITOLA** si përfitues i franshizës. Kontrata është nënshkruar për 3 vjet.

në pikën 20 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që Master franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit dhe në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinobrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

13. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 1.09.2014, ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup, si dhënës i franshizës dhe DTU JUNIORS Klub SHPKNJP Shkup, si përfitues i franshizës Kontrata është lidhur për një periudhë të caktuar prej 4 vitesh.

Në Nenin 8 të Marrëveshjes së theksuar parashihet që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) obligohet që vizitorëve të kursit Brainobrain t'u paguajë kompensim mujor në shumë prej 2460 denarë dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Master Franshizori dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për shfrytëzuesin e franshizës të ndryshojë kompensimin e shkallës që paguajnë dëgjuesit.

14. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup, si dhënës i franshizës, dhe **SHKOLLA EDUKATIVE SIGMA SHPKNJP rr. Ilindenska pn , Kriva Pallankë**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një periudhë të caktuar prej 3 vitesh.

Në Nenin 8 të Marrëveshjes së theksuar parashihet që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) obligohet që vizitorëve të kursit Brainobrain t'u paguajë kompensim mujor në shumë prej 1960 denarë dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Master Franshizori dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për shfrytëzuesin e franshizës të ndryshojë kompensimin e shkallës që paguajnë dëgjuesit.

15. Marrëveshje për bashkëpunim, e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës, dhe **Shoqatës për Edukim dhe Zhvillim të Rinisë ABAKUS, rr. Kosta Novakoviç nr.7/1-3 Shkup**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një periudhë të caktuar prej 3 vitesh.

Në nenin 6 a) të Marrëveshjes në fjalë, parashikohet që dhënësi i franshizës ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë shumën e kompensimit mujor që paguajnë ndjekësit e kursit, dhe në nenin 8 të së njëjtës marrëveshje, parashikohet që përfituesi i franshizës (franshizori/ qendra e franshizës) Brainobrain me rastin e regjistrimit të ndjekësve të kursit, është i obliguar t'u dorëzojë prindërve të ndjekësve të kursit një fletëpagesë, në bazë të së cilës ata do të bëjnë pagesën në shumë prej 2460 denarë në muaj për ndjekjen e kursit.

16. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës, dhe **Shoqërisë për edukim dhe shërbime OKSIGJENI 2013 SHPKNJP Shkup**, si përfituese e franshizës. Kontrata është lidhur për një periudhë të caktuar prej 2 vitesh.

Neni 8 i kësaj Marrëveshjeje parasheh që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2460 denarë, ndërsa neni 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parasheh që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

17. Marrëveshje për bashkëpunim, e lidhur me 01.09.2013, ndërmjet **Breinbrein Internacional SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës, dhe **Shoqatës për zhvillim mendor Brain Ginis - Kumanovë, rr. 3 MUB nr. 124 Kumanovë**, si përfitues i franshizës. Marrëveshja është e vlefshme deri më 01.09. 2016.

në pikën 20 a) nga Marrëveshja e theksuar parashikohet që Master franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit dhe në rregullën 4 të pjesës së titulluar "Rregullat dhe rregulloret Breinbrein" përcaktohet se kompensimi për nivelin që do të ngarkohet dhe arkëtohet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se ndryshimi i shumës së kompensimit kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

18. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.10.2014, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqatës për zhvillim mendor BRAIN-GINIS, Kumanovë**, si përfituese e franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 2-vjeçare.

Neni 8 i kësaj Marrëveshjeje parasheh që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 1960 denarë, ndërsa neni 10 (a) të së njëjtës marrëveshjeje parasheh që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

19. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 1 tetor 2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **TERMAL KOMFORT SHPKNJP Gostivar-Filiali 2 QENDRA PËR EDUKIM MODERN-TCE, rr. Beliçica nr. 51 Gostivar**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, brenda 3 viteve.

Neni 8 i kësaj Marrëveshjeje parasheh që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2000 denarë, ndërsa neni 10 (a) të së njëjtës marrëveshjeje parasheh që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

20. Marrëveshjeje për bashkëpunim, e lidhur më 18.11.2014, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër, rr. Dimitar Vlahov nr. 52, Ohër**, si përfitues i Franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në nenin 6 a) të marrëveshjes së theksuar, parashikohet se BOB (dhënësi i franshizësi) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të konsultohet dhe të bien dakord me Qendrën e Franshizës, të ndryshojnë shumën e kompensimit mujor të cilën e paguajnë ndjekësit e kursit dhe në nenin 8 të së njëjtës marrëveshjeje parashikohet që përfituesi franshizës(franshizori)/qendra e franshizës), Brainobrain me rastin e regjistrimit të ndjekësve të kursit është i obliguar t'u dorëzojë prindërve të ndjekësve të kursit, një fletëpagesë në bazë të së cilës do të paguajnë 1970 denarë në muaj për ndjekjen e kursit.

21. Marrëveshja e bashkëpunimit, e lidhur më 22.01. 2015, ndërmjet **Breinebrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **DA VINÇI GAB SHPKNJP rr. Goce Dellçev, nr. 64 Kumanovë**, si përfitues i Franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në nenin 6 paragrafi (1) pika a) të marrëveshjes në fjalë parashikohet se BOB (dhënësi i franshizës) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë shumën e kompensimit mujor që paguar ndjekësit në kurs dhe në nenin 8 të së njëjtës marrëveshjeje, parashikohet që Qendra e Franshizës, me rastin e regjistrimit të ndjekësve në kursin Brainobrain, detyrohet t'u dorëzojë prindërve të kursistëve një fletëpagesë në bazë të së cilës ata do të bëjnë pagesë në shumë prej 1550 denarë në muaj për ndjekjen e kursit.

22. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 28.04. 2015, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqatës për edukim dhe zhvillim të të rinjve BRAINOBRAIN KIDS, rr. Gemixhiska nr. 57 Shkup**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2000 denarë, ndërsa neni 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

23. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.09.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **BRAINOBRAIN NOVA SHPKNJP Shkup, Rr. Lazar Liçenoski 27, Shkup**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2500 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

24. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 01.09.2015, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës, dhe **SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, Dega I SVETILNIK EDUKARE, rr. Borka Talevski nr. 49/3 Shkup**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2500 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

25. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 03.09.2015, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **E-Konsalting SHPKNJP Koçan, rr. Llazar Andonov nr. 1/1 Koçan**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 1600 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

26. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 14.09.2015, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Shoqatës për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS Shkup, rr. Kosta Novakovuq nr. 7/1-3 Shkup**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2500 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

27. Marrëveshja e franshizës, e lidhur më 21 .09. 2015, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **LINGVA 2006 SHPKNJP Manastir, rr. Marshall Tito nr. 65 Manastir**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2000 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

28. Marrëveshja e franshizës, e lidhur me 01.02.2016, ndërmjet **Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **DUPT ARITMETIKA M SHPKNJP import-eksport Strumicë, rr. Cvetan Dimov nr. 72, Strumicë**, si përfitues i franshizës. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, në afat prej 1 viti.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2000 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

29. Marrëveshja për franshizë, e lidhur më 21.03.2016, ndërmjet **Breinbrein Europe SHPKNJP Shkup**, si dhënës i franshizës dhe **Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër, rr. Dimitar Vlahov nr. 52, Ohër**, si përfitues i franshizës.. Kontrata është lidhur për një kohë të caktuar, për një periudhë 3-vjeçare.

Në Nenin 8 të marrëveshjes së theksuar parashihet që përfituesi i franshizës (franshizori) është i obliguar që nga ndjekësit e kursit Brainobrain të arkëtojë një kompensim mujor në shumë prej 2000 denarë, dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashihet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i Franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak për Shfrytëzuesin e franshizës, të ndryshojnë kompensimin për shkallën që paguajnë dëgjuesit.

KVK vlerësoi gjithashtu deklaratat e Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), se me këto marrëveshje për franshizë , në fakt, përfituesve të franshizës u jepet

përdorimi i një metode specifike dhe teknikat e sistemit Brainbrain si dhe njohuritë dhe përvojat për ta transferuar të njëjtin dhe për ta përvetësuar më lehtë, për zbatimin e drejtë të të cilit, sipas bazave të sistemit të Brainobrain, dhënësi i franshizës është i detyruar të kontrollojë.

Mandej, Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJ, Shkup), theksoi se është duke shqyrtuar mundësinë e heqjes së dispozitave kontestuese që paraqesin shkelje të mundshme, në pajtim me nenin 59 paragrafi (1) pika 1), dhe në lidhje me Neni 7 paragrafi (1) pika 5) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe kërkoi që e njëjta të merret si rrethanë lehtësuese gjatë marrjes së vendimit të Komisionit.

Lidhur me pretendimet e Javor KOP (me emërtimin e mëparshëm: BOB Europe SHPKNJ, Shkup), se me këto marrëveshje të franshizës, në fakt, përfituesve të franshizës u jepet përdorimi i një metode specifike dhe teknikat e sistemit Brainbrain si dhe njohuritë dhe përvojat për ta transferuar të njëjtin dhe për ta përvetësuar më lehtë, për zbatimin e drejtë të të cilit, sipas bazave të sistemit të Brainobrain, dhënësi i franshizës është i detyruar të kontrollojë, KVK thekson se sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), Dekreti për përjashtimin grupor të llojeve të caktuara të marrëveshjeve vertikale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/12) (në tekstin e mëtejme: Dekreti) dhe Udhëzimet për kufizimet vertikale (miratuar më 28.12.2015 nga Komisioni për Mbrojtje të Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KMK), që janë në faqen e internetit të KMK: www.kzk.gov.mk), (në tekstin e mëtejme: Udhëzime), rezulton qartë se Ligji dhe Dekreti zbatohen edhe për marrëveshjet vertikale që përmbajnë dispozita për të drejtat e pronësisë intelektuale (në tekstin e mëtejme: DPI), dhe për rrjedhojë edhe për marrëveshjet e franshizës, dhe se ato nuk duhet të përmbajnë dispozita që kufizojnë aftësinë e blerësit për të vendos çmimin e tij të rishitjes.

Konkretisht, sipas nenit 7 paragrafi (1) pika 5) të Ligjit: "ndalohen të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe sjelljet e harmonizuara, qëllimi apo pasoja e të cilave është shtrembërimi i konkurrencës, dhe veçanërisht ato që kushtëzojnë lidhjen e kontratave duke pranuar nga palët e tjera kontraktuese detyrime shtesë, të cilat për nga natyra e tyre ose sipas zakoneve tregtare nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

Në zbatimin e nenit 7 paragrafi (1) të Ligjit, bëhet dallimi ndërmjet marrëveshjeve që kanë për qëllim kufizimin e konkurrencës dhe marrëveshjeve në të cilat kufizimi i konkurrencës ndodh si pasojë e marrëveshjes.

Prandaj, marrëveshjet dhe dispozitat individuale kontraktuese janë të ndaluara me nenin 7 paragrafi (1) të Ligjit vetëm nëse kanë për qëllim ose pasojë kufizimin e konkurrencës.

Dallimi midis kufizimeve si qëllim dhe kufizimeve si pasojë është i rëndësishëm.

Në momentin kur përcaktohet se një marrëveshje ka për qëllim kufizimin e konkurrencës, nuk ka më nevojë të përcaktohen efektet (pasojat) specifike të asaj marrëveshjeje mbi konkurrencën. Me fjalë të tjera, kur zbatohet neni 7 paragrafi (1) i ligjit, kur marrëveshja ka

për qëllim kufizimin e konkurrencës, nuk është e nevojshme të vërtetohet ekzistenca e efekteve (pasojave) kundër konkurrencës.

Marrëveshjet, vendimet dhe praktikat e bashkërenduara që synojnë kufizimin e konkurrencës janë marrëveshje të tilla, vendime dhe praktika të bashkërenduara që nga natyra e tyre kanë potencial për të kufizuar konkurrencën. Këto janë kufizime të cilat kanë një potencial aq të lartë për efekte negative në konkurrencë, që gjatë zbatimit të nenit 7 paragrafi (1) të Ligjit, nuk është e nevojshme të demonstron njëkohësisht ekzistenca e efekteve negative në treg.

Udhëzimet për atë që përbën një kufizim sipas qëllimit mund të gjenden në Rregulloret e përjashtimit grupor të miratuara sipas ligjit. Kufizimet që janë :në “listën e zezë” në rregulloret e përjashtimit grupor, gjegjësisht identifikohen si kufizime të rënda, paraqesin kufizime sipas qëllimit.

Gjithashtu, në nenin 3 paragrafi (1) të Dekretit është përcaktuar qartë se Marrëveshjet vertikale përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të nenit 7 paragrafi (1) të Ligjit nëse i plotësojnë kushtet e rregulluara me këtë dekret dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi (3) dhe nenin 9 paragrafi (1) pika 2) të të njëjtit ligj. Në nenin 5 të Dekretit janë theksuar kufizimet që nuk duhet të përmbajnë marrëveshjet vertikale dhe në nenin 5 paragrafi (1) pika a) të Dekretit, thuhet qartë se përjashtimi grupor nga neni 3 i Dekretit për përjashtimin grupor të disa llojeve të marrëveshjeve vertikale nuk do të zbatohen për kontratat vertikale të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetëm ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve kontraktuese, synojnë të kufizojnë aftësinë e blerësit për të përcaktuar çmimin e tij të shitjes, pa ndikuar në aftësinë e furnizuesit për të vendosur një çmim maksimal shitjeje ose për të rekomanduar një çmim shitjeje, me kusht që të mos çojë në krijimin e një çmimi fiks ose minimal të shitjes si rezultat i presionit ose stimuljve të ofruar nga ndonjëra nga palët kontraktuese. Nga dispozita e përmendur është se kufizimi i aftësisë së blerësit për të përcaktuar çmimin e tij të shitjes paraqet një kufizim që marrëveshjet vertikale nuk duhet të përmbajnë.

Po ashtu në nenin 3 paragrafi (4) të Dekretit është përcaktuar se përjashtimi grupor nga paragrafi (1) i të njëjtit nen zbatohet edhe për kontratat vertikale, të cilat përmbajnë dispozita për caktimin ose përdorimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të blerësit, me kusht që dispozita të tilla të mos jenë qëllimi kryesor i këtyre marrëveshjeve dhe të lidhen drejtpërdrejt me përdorimin, shitjen ose rishitjen e mallrave ose shërbimeve nga blerësi ose klientët e tij. Përjashtimi grupor zbatohet me kusht që këto dispozita, në lidhje me mallrat ose shërbimet që i nënshtrohen kontratës, të mos përmbajnë kufizime të konkurrencës që kanë të njëjtin qëllim si kufizimet vertikale, të cilat nuk përjashtohen nga Dekreti.

Gjithashtu, në Udhëzimet, në pjesën III, pika 3, shpjegohen më hollësisht kufizimet që nuk duhet të përmbajnë në marrëveshjet vertikale (kufizime të rrepta) sipas Dekretit, ndërsa në pasusin 45 të të njëjtit thuhet se “ kufizimi i rreptë i përcaktuar në nenin 5 paragrafi (1) pika a) të Dekretit për përjashtimin grupor të llojeve të caktuara të marrëveshjeve vertikale i referohet ruajtjes së çmimeve të rishitjes (RÇR), gjegjësisht të marrëveshjeve ose sjelljeve të bashkërenduara që kanë qëllimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të vendosur një çmim fiks ose minimal të rishitjes ose një nivel fiks ose minimal çmimesh të cilat duhet të respektohen

nga blerësi. Në rastin e dispozitave kontraktuale ose sjelljes së përbashkët që përcaktojnë drejtpërdrejt çmimin e rishitjes, kufizimi është i përcaktuar qartë.

Në pikën 36 të Udhëzimeve thuhet se të drejtat e pronësisë intelektuale që janë të rëndësishme për zbatimin e marrëveshjeve vertikale në kuptim të nenit 3(4) të Dekretit i referohen tre fushave kryesore: markave tregtare, të drejtave të autorit dhe Know-how.

Për më tepër, në pikën 41 nga të njëjtat Udhëzime sqarohet se marrëveshjet e franshizës me përjashtim të marrëveshjeve të franshizës industriale, janë një nga shembujt më tipikë ku Know-how për qëllime tregtare i transferohen blerësit. Marrëveshjet e franshizës përmbajnë licenca për të drejtat e pronësisë intelektuale në lidhje me markat tregtare ose shenjat dhe Know-how për përdorimin dhe shpërndarjen e mallrave ose për ofrimin e shërbimeve. Përveç licencës së DPI-së, dhënësi i franshizës zakonisht i ofron përfituesit të franshizës gjatë kontratës, asistencë komerciale ose teknike, siç janë shërbimet e dërgesës, trajnimi, konsultimet për pasuritë e paluajtshme, planifikimi financiar, etj. Licenca dhe asistenca janë pjesë përbërëse e metodës së tregtimit që është objekt i franshizës.

Në pikën 41 të Udhëzimeve theksohen detyrimet e lidhura me DPI-së të cilat zakonisht konsiderohen të nevojshme për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të dhënësit të franshizës dhe, kur këto detyrime hyjnë në fushën e nenit 7 paragrafi (1) të ligjit, përjashtohen gjithashtu me Dekret:

- (a) detyrimi i përfituesit të franshizës për të mos marrë pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në një aktivitet tjetër të ngjashëm;
- (b) detyrimi i përfituesit të franshizës për të mos marrë aksione financiare nga kapitali i një ndërmarrje të caktuar konkurruese, në mënyrë që përfituesit të franshizës t'i jepet e drejta të ndikojë në marrëdhëniet ekonomike të asaj ndërmarrje;
- (c) detyrimi i përfituesit të franshizës të mos u zbuloj palëve të treta know-how nga dhënësi i franshizës derisa know-how të bëhen publike;
- (d) detyrimi i përfituesit të franshizës t'i transmetoj dhënësit të franshizës çdo përvojë të fituar gjatë përdorimit të franshizës dhe t'i sigurojë dhënësit të franshizës dhe përfituesve të tjerë të franshizës një licencë jo-ekskluzive për know-how që rrjedhin nga kjo përvojë;
- (e) detyrimi i përfituesit të franshizës të informojë dhënësin e franshizës për shkeljet e të drejtave të licencuara të pronësisë intelektuale, të ndërmarrë veprime ligjore kundër shkelësve ose të ndihmojë dhënësin e franshizës në çdo veprim ligjor kundër shkelësve;
- (f) detyrimi i përfituesit të franshizës të mos përdor know-how e licencuara nga dhënësi i franshizës për qëllime të tjera, përveç përdorimit të franshizës;

(g) detyrimi i përfituesit të franshizës është të mos transferojë të drejtat dhe detyrimet e marrëveshjes së franshizës pa pëlqimin e dhënësit të franshizës.

Në pikën 176 të Udhëzimeve, sqarohet se marrëveshjet e franshizës përmbajnë licenca për të drejtat e pronësisë intelektuale që lidhen me marka ose shenja të caktuara dhe know-how për përdorimin dhe shpërndarjen e mallrave ose për ofrimin e shërbimeve. Përveç licencës së DPI-së, dhënësi i franshizës zakonisht i siguron përfituesit të franshizës, gjatë kontratës, asistencë komerciale ose teknike. Licenca dhe asistenca janë pjesë përbërëse e metodës së tregtimit që i nënshtrohet franshizës. Dhënësit të franshizës zakonisht i paguhet një taksë e franshizës nga përfituesi i franshizës për përdorimin e metodës specifike të biznesit. Përveç parimit të metodës së biznesit, marrëveshjet e franshizës zakonisht përmbajnë një kombinim të kufizimeve të ndryshme vertikale në lidhje me produktet e shpërndara, veçanërisht me shpërndarjen selektive dhe/ose detyrimi për mos konkurrim dhe/ose shpërndarje ekskluzive ose disa forma më të dobëta të saj.

Nga dispozitat e mësipërme të Ligjit, Dekretit dhe Udhëzimeve, rezulton qartë se Ligji dhe Dekreti zbatohen edhe për kontratat vertikale që përmbajnë dispozita për të DPI dhe se ato nuk duhet të përmbajnë dispozita të cilat kufizojnë aftësinë e blerësit për të përcaktuar çmimin e vetë të rishitjes.

Nga ajo që u tha mësipërm, KVK, konstatoi se Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe DOOEL, Shkup), si ndërmarrje dhënëse e franshizës për Kurse - kurs i avancuar për zhvillimin mendor të fëmijëve të moshës 4 deri në 14 vjeç, që kryhet sipas metodës së të mësuarit të mbrojtur me emrin "Brainiobrain", në periudhën prej datës 30.10.2011, si ditë kur është lidhur marrëveshja e parë e franshizës deri më 01.09.2018, si ditë e përfundimit të marrëveshjes së franshizës të lidhur në mes të Javor KOP (emri i mëparshëm : BOB Europe SHPKNJP, Shkup) dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, filiali SVETILNIK EDUKARE, si dita e përfundimit të marrëveshjes së fundit që përmbante një dispozitë kufizuese në 29 raste, e kushtëzonte lidhjen e marrëveshjeve të franshizës me përfituesit e franshizës me pranimin e një detyrimi nga ana e përfituesit të franshizës, detyrime shtesë, të cilat për nga natyra e tyre ose në përputhje me zakonet tregtare nuk janë të lidhura me objektin e kontratës, në mënyrë të tillë që në:

-marrëveshjet e franshizës të lidhura me **Organizatën Komunale të Kryqit të Kuq Ohër, Maqedoni** (më 30.10.2011), Abakus Plus - Manastir (më 30.10.2011), Qendra Edukative Svetilnik, Shkup (më 30.10.2011), Xhonova Xhaxhova Emilija, Shtip (më 01.03.2012) dhe E-Konsalting, Koçan (më 01.03.2012), në pikën 6.3 a) parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 8 të pjesës të titulluar "Orari" nga të njëjtat kontrata, përcaktohet një tarifë mujore fikse që shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) do t'i mbledhë nga studentët e tij në muaj dhe gjithashtu në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrein dhe dispozitat" parashikohet një tarifë fikse mujore për nivel, e cila do të tarifohet dhe do të mbledhet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student dhe se një ndryshim në shumën e tarifës kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

-marrëveshjet e franshizës të lidhura me: Brainobrain Juniors, Shkup (më 01.09.2012) dhe Fruitberry SHPKNJP Strumica- filiali Vonderkit (më 01.09.2012), në pikën 6.3 a) parashikohet që dhënësi i franshizës (franshizuesi/kompania) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në pikën 22 të pjesës së titulluar "Orari" nga e njëjta kontratë, që Master Franshizori përcakton 3 kategori tarifash fikse për tarifimin mujor të kursit Breinobrain për çdo student në varësi të numrit të banoreve në qytet dhe në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrain dhe dispozitat" parashikohet një tarifë fikse mujore për nivel, e cila do të tarifohet dhe do të mblidhet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student dhe se një ndryshim në shumën e tarifës kërkon miratimin me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

-marrëveshjet për franshizë të lidhura me: Qendrën Edukative Svetilnik (më 01.09.2012), Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime NETING SHPKNJP import-eksport (më 01.12.2013), Qendra Edukative Svetilnik Shkup (më 01.02.2012), ELMO - TEHNA Lubenço import-eksport (më 24.09.2013), MALI GENIJALCI SHPKNJP, Manastir (më 01.04.2014) dhe Shoqata për zhvillim mendor Brain Ginis - Kumanovë (më 01.09.2013), në Nenin 20 a) parashikohet që Master Franshizori ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë tarifën për seminar që paguajnë pjesëmarrësit, në rregullin 4 të pjesës së titulluar "Rregullat Breinobrain dhe dispozitat" parashikohet që kompensimi për nivel, që do të paguhet dhe mblidhet nga shfrytëzuesi i franshizës (franshizori) nga çdo student në muaj dhe se për ndryshimin e shumës së kompensimit kërkohej miratim me shkrim të marrë nga Master Franshizori.

-marrëveshjet e franshizës të lidhura me: DTU JUNIORS Klub SHPKNJP Shkup (më 01.09.2014), SHKOLLA EDUKATIVE SIGMA SHPKNJP, Kriva Pallankë (më 01.10.2014), Shoqata për edukim dhe shërbime OKSIGJENI 2013 SHPKNJP Shkup (më 01.10.14). Shoqata për zhvillim mendor BRAIN-GINIS, Kumanovë (më 01.10.2014), TERMAL KOMFORT SHPKNJP Gostivar (më 01.10.2014), Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve BRAINOBRRAIN KIDS, Shkup (më 28.04.2015), BRAINOBRRAIN NOVA SHPKNJP Shkup (më 01.09.2015), SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup (më 01.09.2015), E-Konsalting DOO, Koçan (më 03.09.2015), Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS, Shkup (më 14.09.2015), LINGVA 2006 SHPKNJP, Manastir (më 21.09.2015), DUPT ARITMETIKA M SHPKNJP import-eksport, Strumicë (më 01.02.2016) dhe Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë-Organizata Komunale Ohër (më 21.03.2016), në nenin 8 parashikohet që përfituesi i franshizës (franshizori) detyrohet nga vizitorët e kursit të Brainobrain të paguaj një tarifë mujore fikse dhe në nenin 10 (a) të së njëjtës marrëveshje parashikohet që Dhënësi i master franshizës dhe Dhënësi i franshizës kanë të drejtë, me njoftim paraprak të Shfrytëzuesit të Franshizës, të ndryshojë tarifën për shkallën që e paguajnë dëgjuesit DHE

-marrëveshjet për franshizë janë lidhur me: Shoqatën për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS, Shkup (më 01.10.2014), Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë - Organizata Komunale Ohër (më 18.11.2014) dhe DA VINÇI GAB SHPKNJP, Kumanovë (më 22.01. .2015), në nenin 6 a) parashikohet se BOB (dhënësi i franshizës) ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë shumën e kompensimit mujor që paguajnë ndjekësit në kurs dhe në nenin 8 të së njëjtës marrëveshje, parashikohet që Qendra e Franshizës, me rastin e regjistrimit të

ndjekësve në kursin Brainobrain, detyrohet t'u dorëzojë prindërve të kursistëve një fletëpagesë në bazë të së cilës ata do të paguajnë një tarifë fikse mujore për ndjekjen e kursit, që paraqet **shkelje të shumta të nenit 59 paragrafi (1) pika 1), dhe në lidhje me nenin 7 paragrafi (1) pika 5) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe nenit 28 paragrafi (1) të ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 124/15).**

Përkatësisht, siç u tha më lartë, gjatë procedurës Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) ka dorëzuar Njoftim për marrëveshjet e ndryshuara dhe ia ka dorëzuar KVK-së marrëveshjet e ndryshuara. Nga inspektimi i kryer në marrëveshjet e ndryshuara, KVK konstatoi se:

-Marrëveshja e Franshizës e lidhur më 01.09.2014, ndërmjet **Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP Shkup)**, si dhënës i franshizës dhe DTU JUNIORS Klub SHPKNJP Shkup, si përfitues i franshizës, që u lidh për një periudhë 4 vjeçare, është ndryshua me Aneks, por me Aneksin e marrëveshjes nuk u ndryshuan dispozitat e nenit 8 dhe nenit 10, që KVK i konstatoi se ishin dispozita kufizuese.

-Marrëveshja e Franshizës e lidhur më 22.01.2015, ndërmjet **Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP Shkup)**, si dhënës i franshizës dhe DA VINÇI GAB SHPKNJP, rr. Goce Dellçev 64, Kumanovë, si përfitues i franshizës, që është lidhur për 3 vjet, është ndryshuar me aneks, por me aneksin e marrëveshjes nuk u ndryshua neni 6 paragrafi (1) pika a) e marrëveshjes në fjalë, për të cilën KVK konstatoi se ishte një dispozitë kufizuese.

-Marrëveshja e Franshizës e lidhur më 01.01.2015, ndërmjet **Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP Shkup)**, si dhënës i franshizës dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, Filial i SVETILNIK EDUKARE rr. Borka Talevski nr.49/3 Shkup si përfitues i franshizës, që është lidhur për 3 vjet, është ndryshuar me aneks, por me aneksin e marrëveshjes nuk u ndryshua neni 8 dhe neni 10 paragrafi (1) pika a) e marrëveshjes në fjalë, për të cilën KVK konstatoi se ishte një dispozitë kufizuese.

-Marrëveshja e Franshizës e lidhur më 14.09.2015, ndërmjet **Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP Shkup)**, si dhënës i franshizës dhe Shoqata për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS rr. Kosta Novakoviç nr. 7/1-3 Shkup, si përfitues i franshizës, që është lidhur për 3 vjet, është ndryshuar me aneks, por me aneksin e marrëveshjes nuk u ndryshua neni 8 dhe neni 10 paragrafi (1) pika a) e marrëveshjes në fjalë, për të cilën KVK konstatoi se ishte një dispozitë kufizuese.

Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup), dorëzoi në KVK Anekset e marrëveshjeve të lidhura pas miratimit të Aktvendimit të KVK –së PK nr. 09-8/12, datë 29.11.2017, përkatësisht:

-Aneksi nr. 2 i Marrëveshjes për franshizë të datës 14.09.2015, e lidhur në Shkup, më 06.12.2017, ndërmjet Breinobrain Europe SHPKNJP Shkup, si dhënës i franshizës, dhe Shoqatës për edukim dhe zhvillim të të rinjve ABAKUS, rr. Kosta Novakoviç nr. 7/1-3 Shkup, si përfitues i franshizës, ku janë bërë ndryshime në nenet kontestuese, përkatësisht në tekstin e spastruar të nenit 8 i cili thotë: "Nga vizitorët e kursit Brainobrain, të paguajnë një kompensim mujor për ndjekjen e kursit. Dhënësi i Franshizës rekomandon pagesë mujore për

ndjekjen e një kursi në shumë prej 2500 denarë,” dhe teksti i spastruar i nenit 10 i cili thotë " dhënësi i Master franshizës dhe dhënësi i franshizës kanë të drejtë, me miratimin paraprak me shkrim të përfituesit të Franshizës, të ndryshojë metodat dhe procedurat e kurseve të Brainobrain dhe përmbajtjen e materialeve të Brainobrain". Pasi janë bërë ndryshimet e duhura, kundërvajtja përfundon më 06.12.2017.

-Aneksi nr. 2 i Marrëveshjes për franshizë e datës 01.09.2014, e lidhur në Shkup, më 06.12.2017, ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJPS Shkup, si dhënës i franshizës, dhe Shoqërisë për tregti dhe shërbime QENDRA EDUKATIVE JUNIORS KLUB SHPKNJP Shkup, rr. Meksiçka nr. 14 b Shkup, si përfitues i franshizës, ku janë bërë ndryshime në nenet kontestuese, përkatësisht në tekstin e spastruar të nenit 8 i cili thotë: “Nga vizitorët e kursit Brainobrain, të paguajnë një kompensim mujor për ndjekjen e kursit. Dhënësi i Franshizës *rekomandon* pagesë mujore për ndjekjen e një kursi në shumë prej 2500 denarë,” dhe teksti i spastruar i nenit 10 i cili thotë " dhënësi i Master franshizës dhe dhënësi i franshizës kanë të drejtë, me miratimin paraprak me shkrim të përfituesit të Franshizës, të ndryshojë metodat dhe procedurat e kurseve të Brainobrain dhe përmbajtjen e materialeve të Brainobrain". Pasi janë bërë ndryshimet e duhura, kundërvajtja përfundon më 06.12.2017.

-Aneksi nr. 2 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 22.01.2015, lidhur në Shkup, më 06.12.2017, ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup, si dhënës i franshizës, dhe DA VINÇI GAB SHPKNJP import-eksport Kumanovë, rruga Goce Dellçev nr. 64, Kumanovë, si përfituese e franshizës, ku është bërë një ndryshim në nenin e kontestuar, përkatësisht tekstin e spastruar të nenit 6 paragrafi (1) pika a) i cili thotë: "BOB ka të drejtë, me njoftim paraprak, të ndryshojë metodat dhe procedurat e kurseve të Brainobrain dhe përmbajtjen e materialeve të Brainobrain". Pasi janë bërë ndryshimet e duhura, kundërvajtja përfundon më 06.12.2017.

Aneksi i marrëveshjes së franshizës të datës 01.09.2015, i lidhur në Shkup, i nënshkruar më 07.06.2017, ndërmjet Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup, si dhënës i franshizës, dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, rr. Borka Talevski nr.49/3 Shkup, si përfitues i franshizës, ku ishte e nevojshme të ndryshohej neni 8 dhe neni 10 paragrafi (1) pika a) në Marrëveshjen e franshizës të datës 1 shtator 2015, por është ndryshuar dhe plotësuar vetëm neni 5 i së njëjtës marrëveshje, i cili nuk ka të bëjë me shkeljen e konstatuar në dispozitiv të Aktvendimit të KVK të datës 29.11.2017, Aktvendimi PK nr. 09-8/12. Meqenëse Marrëveshja e Franshizës nga 01.09.2015 është lidhur në kohëzgjatje prej 3 vitesh, gjegjësisht ka qenë e vlefshme deri më 01.09.2018, dhe nga miratimi i Aktvendimit të KVK-së më 29.11.2017 e deri në skadimin e marrëveshjes, nuk është dorëzuar ndonjë aneks shtesë në KVK, KVK do të konsiderojë se kohëzgjatja e kundërvajtjes është deri në datën e skadimit të Marrëveshjes së Franshizës, e lidhur në mes Breinobrein Europe SHPKNJP Shkup, si dhënës i franshizës dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, rr. Borka Talevski nr. 49/3 Shkup, si përfitues i franshizës, gjegjësisht deri më 01.09.2018.

Prandaj, shkelja e përmendur ka zgjatur prej datës 30.10.2011, si ditë kur është lidhur marrëveshja e parë e franshizës, deri më 01.09.2018, si ditë e përfundimit të marrëveshjes për franshizë të lidhur në mes të Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup.)

dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, filial I SVETILNIK EDUKARE, si ditë e përfundimit të marrëveshjes së fundit e cila përmbante dispozitë kufizuese.

Në procedurën e përsëritur, KVK ka marrë parasysh udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Lartë Administrative në aktgjykimin e UPRZH nr. 155/2020.

Në aktgjykimin e saj, UPRZH. Nr. 155/2020, GjLA iu referua nenit 2 paragrafi (1) të Ligjit për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 96/2019), si dhe për kundërvajtjen dhe përgjegjësin e kundërvajtjes në përputhje me rrethanat zbatohen dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Në aktgjykimin e saj, UPRZH. Nr. 155/2020, GjLA iu referua nenit 16 paragrafi (1) të Ligjit për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 96/2019), sipas cilit nen kryesit të kundërvajtjes i caktohet një sanksion për kundërvajtje brenda kufijve të përcaktuar me ligj për veprën e kryer, duke marrë parasysh përgjegjësinë kundërvajtës të kryesit dhe peshën e veprës së kryer.

Në aktgjykimin e saj, UPRZH. Nr. 155/2020, GjLA iu referua nenit 26 paragrafi (1) të të njëjtit ligj, sipas të cilit gjoba për personin fizik konsiston në pagesën e një shume të caktuar parash e cila nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë në denarë, as më shumë se 250 euro në kundërvlerë në denarë, përveç nëse me legjislacionin e Bashkimit Evropian është përcaktuar ndryshe. Sipas paragrafit (2) të të njëjtit nen, gjoba për personin përgjegjës në personin juridik dhe personin zyrtar të autorizuar nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në denarë, e as më shumë se 500 euro në denarë, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga legjislacioni i Bashkimit Evropian. Sipas paragrafit (5) të të njëjtit nen, për kundërvajtje nga sfera e konkurrencës, energjisë, komunikimeve elektronike, tregtisë me mallra të ndaluara dhe/ose të kufizuara për përdorim, kundërvajtje të kryera nga interesi vetjak, ose për kundërvajtje që shkaktojnë dëme më të mëdha pronësore, mund të caktohet gjobë deri në dyfishin e shumës maksimale ose në përpjesëtim me masën e dëmit të shkaktuar ose dobisë së përfituar, por më së shumti deri në dhjetëfishin e shumës në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

Në aktgjykimin e saj, UPRZH. Nr. 155/2020, GjLA i referohet nenit 3 paragrafi (1) dhe (2) të Kodit Penal (Gazeta Zyrtare e RM nr. 80/99.....248/18), gjegjësisht se ndaj kryesit të veprës penale zbatohet ligji që ka qenë i vlefshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Nëse pas kryerjes së veprës penale, ligji është ndryshuar një ose më shumë herë, do të zbatohet ligji që është më i butë ndaj kryesit.

Në aktgjykimin e saj, UPRZH. Nr. 155/2020, GjLA vlerësoi se organi i shkallës së parë (në rastin konkret KVK) saktë ka konstatuar gjendjen faktike lidhur me përgjegjësinë e paditësit (në rastin konkret Javor KOP (i njohur më parë si: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) për veprën e kryer , e cila u pranua si e saktë edhe nga Gjykata Administrative, megjithatë, gjatë vlerësimit të gjobës nga Gjykata Administrative, nuk është vlerësuar se ndërkohë ka hyrë në fuqi Ligji për kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e RM nr. 96/2019) i datës 17.05.2019, i cili parashikon gjoba më të lehta për shkelësit dhe që duhet të ishin zbatuar në rastin konkret.

Sipas udhëzimeve të GjLA lidhur me shumën e gjobës, KVK duhet të plotësojë gjendjen faktike të rrethanave që janë me ndikim për vlerësimin e drejtë të saj në përputhje me dispozitat ligjore të cekura në aktgjykim dhe në të njëjtën kohë të zbatojë një ligj që është më i butë për kryerësit e veprës.

Sipas asaj që u theksua më sipër, KVK merr parasysh udhëzimet e GjLA se KVK gjatë caktimit të gjobës ka zbatuar një ligj më pak të favorshëm për autorët. Në aktgjykimin UPRZH. Nr. 155/2020 i datës 06.09.2022, GjLA konstatoi se KVK-ja gjatë caktimit të shumës së gjobës për kundërvajtje që i ngarkohet kundërvajtësit, nuk ka marrë parasysh nenin 3 paragrafi 2 të Kodit Penal të cilit i referohet neni 2 paragrafi 1 i Ligjit për Kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 124/15) sipas të cilit, nëse pas kryerjes së veprës penale është ndryshuar ligji një ose më shumë herë, do të zbatohet ligji që është më i butë ndaj shkelësit. Mandej, GjLA theksoi se në rigjykim, gjatë caktimit të lartësisë së sanksionit të kundërvajtjes – gjobë për kundërvajtjet që i ngarkohen kryesve, KVK duhet të zbatojë Ligjin për Kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19), si ligj më i butë. Njëkohësisht, gjatë caktimit të lartësisë së sanksionit për kundërvajtje – gjobë, KVK duhet t'i vërtetojë faktet në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19) dhe nenit 26 paragrafit 5 të ligjit në fjalë, sipas të cilit, për kundërvajtje në fushën e konkurrencës, energjisë, komunikimeve elektronike, tregtisë së mallrave të ndaluara dhe/ose të kufizuara për përdorim, kundërvajtje të kryera nga interesi vetjak ose për shkelje që shkaktojnë dëme më të mëdha pronësore, mund të caktohet gjobë deri në dyfishin e shumës maksimale ose në përpjesëtim me shumën e dëmit të shkaktuar ose dobisë së përfituar, por më së shumti deri në dhjetëfishin e shumës në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

Duke vepruar sipas udhëzimeve të GjLA në rigjykim, KVK merr parasysh nenin 3 paragrafi 2 të Kodit Penal dhe nenin 2 paragrafi 1 të Ligjit për Kundërvajtjet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/ 15 dhe nr. 211/16) sipas të cilit, nëse ligji është ndryshuar pas kryerjes së veprës penale, një ose më shumë herë, do të zbatohet ligji që është më i butë për shkelësin. Prandaj, duke zbatuar nenin 26 paragrafin 5 të Ligjit për Kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19), si ligj më i butë sipas GjLA-së në aktgjykimin e tij, KVK konstatoi se **i njëjti i referohet gjobës si sanksion kundërvajtës që i shqiptohet kryesit të shkeljes që është personi fizik.** Duke marrë parasysh se kryesi i kundërvajtjes Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) është person juridik, KVK nuk mund të zbatojë nenin e përmendur.

Për këto arsye, KVK në riprocedurë ka vlerësuar nenin 36 paragrafi (5) të Ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19), i cili parasheh sanksione penale për personat juridikë si autorë, sipas të cilat për kundërvajtje në fushën e konkurrencës, komunikimeve elektronike dhe tregtisë së mallrave të ndaluara dhe/ose të kufizuara, si dhe në fusha të tjera që mbulohen nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, mund të parashikohet një gjobë në përqindje, por maksimumi deri në 10% të të ardhurave të personit juridik të realizuara në vitin paraardhës fiskal. Prandaj, KVK konstatoi se neni 36 paragrafi (5) i Ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19) parasheh të njëjtin sanksion kundërvajtës– gjobë si neni 59 paragrafi (1) pika 1) të LMK-së, sipas të cilit ndërmarrja, përkatësisht shoqata e ndërmarrjeve, me aktvendim do të shqiptojë gjobë në masën deri në 10% të vlerës së totalit

të të ardhurave vjetore të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në vlerë absolute dhe nominale për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka përpiluar llogari vjetore, nëse ai lidh një marrëveshje të ndaluar ose merr pjesë ndryshe në një marrëveshje, vendim ose sjellje të bashkërenduar.

KVK konstatoi se në periudhën kur është kryer kundërvajtja **nga data 30.10.2011, si ditë kur është lidhur marrëveshja e parë e franshizës deri më 01.09.2018, si ditë e përfundimit të marrëveshjes së franshizës të lidhur ndërmjet Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup) dhe SVETILNIK EDUKARE SHPKNJP Shkup, Filiali I SVETILNIK EDUKARE, si ditë e përfundimit të marrëveshjes së fundit e cila përmbante dispozitë kufizuese**, krahas LMK-së, vlente edhe Ligji për kundërvajtje (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 124. /15 dhe nr. 211/16). Në ligjin e përmendur, në nenin 38 paragrafi (7) është paraparë, **për kundërvajtje të caktuara nga sfera e mbrojtjes së konkurrencës**, kundërvajtjet më të rënda të kategorizuara në fushën e mjedisit jetësor, si dhe në fusha të tjera të përcaktuara me ligj, **mund të caktohet një gjobë në përqindje që është deri në 2% të totalit të të ardhurave të personit juridik në vitin paraardhës financiar**, dhe në lidhje me kundërvajtjet e veçanta në fushën e komunikimeve elektronike deri në 10% të totalit të të ardhurave të personit juridik në vitin paraardhës financiar.

KVK gjatë përcaktimit të gjobës ka marrë parasysh të gjitha udhëzimet e mësipërme të GjLJA, por duke pasur parasysh faktin se në vitin 2021, si viti i fundit financiar, vlera e të ardhurave totale vjetore të realizuara nga **Javor KOP (emri i mëparshëm: BOB Europe SHPKNJP, Shkup)** është 0 denarë, KVK të njëjtit **nuk i shqipton gjobë**.

Për shkak të të gjithë asaj që u tha më sipër, KVK vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për inicim të kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Padia vonon ekzekutimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KOMISIONI Vendimmarrës PËR KUNDËRVAJTJE

KRYETAR

Димитрија Вревезоски